

## **Hapet thirrja për aplikime për bursa në Universitetin e Messinës, për trajnim për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në kuadër të Programit Erasmus + KA 107.**

Në kuadër të Programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për trajnim në Universitetin e Messinës në Itali, për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në kuadër të Programit Erasmus + KA107 për vitin akademik 2018 - 2019.

### **Llojet e mobilitetit:**

-Shkëmbimin e stafit akademik me kohë të plotë për trajnim në datat 10-14 qershor 2019;

### **Fushat e shkëmbimit:**

- Biologji;

Për më shumë informacion referohuni linkut:

<https://www.unime.it/it>

### **Kohëzgjatja e bursave:**

- 5 ditë +2 ditët e udhëtimit;

### **Bursat përfshijnë:**

-Kompensimin për stafin (140 EUR në ditë për stafin);

-Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

| <b>DISTANCA E UDHËTIMIT</b><br>( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> ) | <b>Kompensimi</b> |
|--|-------------------|
| <b>Midis 100 dhe 499 KM</b>  | 180 EUR           |
| <b>Midis 500 dhe 1999 KM</b>   | 275 EUR           |
| <b>Midis 2000 dhe 2999 KM</b>  | 360 EUR           |
| <b>Midis 3000 dhe 3999 KM</b>  | 530 EUR           |
| <b>Midis 4000 dhe 7999 KM</b>  | 820 EUR           |
| <b>8000 KM ose më shumë</b>  | 1100 EUR          |

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

## **Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik:**

- CV + Lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj (që vërteton njohuritë e gjuhës angleze/italiane niveli B2);
- Vetëdeklarim nëse keni kryer ose jo më parë mobilitet Erasmus+, nëse po, ku;
- Plani i mobilitetit për trajnim\*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Trajnim klikoni në adresën:

[http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Training\\_Mobility\\_Plan.pdf](http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Training_Mobility_Plan.pdf)

\*Plani i Mobilitetit për trajnim është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së trajnimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

**Afati për aplikim:** 01 Prill 2019

Dokumentacioni duhet dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe të skanuara të dërgohen në adresën [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Universiteti i Tiranës ju uron Suksese në aplikim!